



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

TEATRI KOMBËTAR I OPERAS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR

Nr 262 Prot

Tiranë më 26/01 /2022

NJOFTIM

Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor, në mbështetje të Statutit të Institucionit të TKOBAP miratuar me urdhër të Ministrit të Ministrisë së Kulturës nr 166 datë 27.04.2015; Rregullores së Brendshme të Institucionit; Organikës dhe Strukturës së Institucionit miratuar me Urdhër të Kryeministrit nr 140, datë 28.03.2014, shpall 3 (tre) vende vakante për pozicionin e punës Balerin/e në Drejtorinë e Baletit.

❖ Balerin/e - 3 (tre) vende

Njoftojmë të gjithë të interesuarit se në datën 19/02/2022 ora 11:00 në **Sallën e Baletit**, në katin e tretë brenda ambienteve të Teatrit Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor do të zhvillohet audicioni për vendet vakante Balerin/e në pranë Drejtorisë së Baletit.

Të gjithë ata artistë të jashtëm të interesuar për pjesëmarrje për këto vende vakante duhet të dorëzojnë pranë sekretarisë së TKOBAP deri me datë 12/02/2021 ora 14:00 dokumentat e nevojshme për regjistrim si më poshtë vijon;

1. Të ketë përfunduar Shkollën Kombëtare të Baletit brenda ose jashtë vendit;
2. Diplomë e përfundimit të shkollës dhe listë notash të noterizuara;
3. Fotokopje e dokumentit të identitetit të vlefshëm;
4. CV bashkangjitur me Foto;
5. Një kopje të Curriculum Vitae bashkëngjitur me Foto, (veprimtaria e 2 viteve të fundit e çertifikuar, programe shfaqjesh, recitalesh të ndryshme, si dhe të dhëna të tjera që plotësojnë figurën artistike, eksperiencë pune për pozicionin që konkurojnë, etj); Dokumentacionin e nevojshëm për të vërtetuar këtë kriter.

Kriteret e veçanta të kualifikimit për vendin vakant: Balerin/e (femra dhe meshkuj) si vijon:

1. Ushtrimet e Baletit (të gjithë balerinët që marrin pjesë në audicion);
2. Variacione nga repertori klasik botëror;
 - a) Një variacion klasik (i detyrueshëm sipas variantit në linkun më poshtë)
 - Për vajzat – Variacion Sugar Plum <https://youtu.be/zV1qLYukTH8>
 - Për djemtë- Variacion djemsh <https://youtu.be/Iz9fqHJdrZc>

- b) Një variacion klasik karakter sipas dëshirës së balerinëve konkurentë.
- 3. Monolog neoklasik ose kontemporan;
- 4. Kërkesa më lëvizje specifike mbi teknikën e duetit klasik;
- 5. Realizimi i një materiali të shkurtër koreografik (a prima vista)

Punoi kriteret e përgjithshme: Juriste Migena BIBA 

Pranoi: Drejtor i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse Aida GEGAJ 

Konceptoi artistikisht: Alisa Gjoni -Dirigjente Baleti 

Dion Gjini -Përgjegjës baleti; 

Ledia Sulaj - Soliste e Parë Baleti 

MIRATOI
DREJTORE E PËRGJITHSHME
ZANA CELA

